



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Sherbime elektrike

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

2.000.000 (Dy milion) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKSH ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Fondi limit është perlogaritur nga Sektori i Planifikim -raportim bazuar ne urdherin nr. 326, date 09.05.2024.

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i Pompës</b>	<b>Të dhëna teknike</b>	<b>Shenime</b>	<b>Sasia per riparim</b>
1	Riparim Elektropompe zhytесе U.Zeza – 13,5 kw (AVOLZHIM)	<b>Pompe zhytесе per ujra te zeza, FLYGT Tip-N3153 HT,181-1510659</b> 450 /289 mm - St.U-Z Final 2 ,Velipoje	Skatulla e pompes me ate te elektromotorit eshte monoblok.	1
2	Riparim Elektropompe zhytесе U.Zeza 2 kw, (AVOLZHIM)	<b>FLYGT N Tip-3085.160-1511486460</b> impeller n= 1405 rrot/min) S1 U=400V 3~ 50hz ITUN Velipoje	Skatulla e pompes me ate te elektromotorit eshte monoblok.	1

3	Riparim Elektropompe zhytесе U.Zeza 1,5 kw (AVOLZHIM)	<b>FLYGT N Tip-3068.180-1520203461</b> impeller n= 1405 rrot/min) S1 U=400V 3~ 50hz ITUN Velipoje-Stacioni Prekaj ITUN Shiroke-	Skatulla e pompes me ate te elektromotorit eshte monoblok.	1
4	Riparim Transformator 6/04kv 300 KVA (AVOLZHIM)	Transformimi:6/04 kv, Fuqia:300 KVA, Stacioni ujit pishem Gur i Zi.	Transformatori eshte me vaj.	1
5	Riparim Transformator 35/04kv 1100 KVA (AVOLZHIM)	Transformimi:35/04 kv, Fuqia:1100 KVA, Stacioni ujit pishem TRUSH.	Transformatori eshte me vaj	1
6	Riparim Transformator 35/04kv 1600 KVA (AVOLZHIM)	Transformimi:35/04 kv, Fuqia:1600 KVA ITUN Velipoje	Transformatori eshte me vaj	1
7	Sherbim Transformator 6/04kv 100 KVA	Transformimi:6/04 kv, Fuqia:100 KVA, Rezerve Stacioni ujit pishem .	Transformatori eshte me vaj.	1

## 1. QELLIMI

Ky specifikim mbulon transformatoret e shperndarjes 6/0.4; 10/0.4; 20/0.4 dhe 35/0.4 kV per perdorim ne ambient te brendshem dhe te jashtem.

## 2. KERKESA TE DETYRUESHME

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje te dhena teknike ( pjese e specifikimeve teknike) si pjese integrale e propozimit te tyre.

- Te dhena teknike (TDSH) plotesuar sic kerkohen me poshte
- Emri I llojit, vendi I riparimit
- Skemat me dimensione perfshire vendndodhjen dhe pershkrimi I terminaleve te peshtjelles ne mbulesa
- Pershkrimi ne pllakate
- Pesha e vajit
- Udhezime per perdorim (veprim), vendosje ne pune, mirembajtje
- Sistemi I kontrollit te cilesise, certifikatat
- Kerkesa per transportin dhe vendosjen
- Protokolli I testeve dhe lista e testeve
- Impakti ne ambient
- Deklarimi I statusit per ricikilimin e materialeve te perdorura

### **3. KERKESA TE PERGJITHSHME**

#### **3.1 Specifikime Reference**

Transformoret duhet te furnizohen dhe testohen ne perputhje me specifikimet te Komisionit Nderkombetar Elektroteknik:

- Insulation co-ordination IEC 71*
- Power transformers IEC 76*
- Bushings for alternating voltages above 1000 V IEC 137*
- Dimensions of tubes, pins and rods of ferromagnetic oxides IEC 220*
- Tests on hollow insulators for use in electrical equipment IEC 233*
- Partial discharge measurements IEC 270*
- Specification for unused mineral insulating oils for*

*transformers and switchgear IEC 296*

- *Degrees of protection provided by enclosures (IP Code) IEC 529*
- *Determination of transformer and reactor sound levels IEC 551*
- *Specification for structural steel ASTM A36*

Percaktimet e dhena me siper sipas publikimeve te IEC do te aplikohen me poshte.

Ne rast se kerkesat e meposhtme ndryshojne nga ato te dhena ne IEC te mesiperme, ne nje fushe te vecante, transformoret duhet te plotesojne kerkesat e listuara me poshte sipas ketij artikulli.

Per kete qellim skemat dhe llogaritjet sipas sistemit SI do te perdoren.

#### **3.2 KUSHTET E SHERBIMIT**

Strukturat , paisjet dhe te gjitha aksesoret duhet te jene te pershtatshem per perdorim nen kushtet e meposhtme.

#### **SHKALLA E KONTAMINIMIT**

Niveli i ndotjes konsiderohet si ndotje e pakapshme. Distanca e shkarkimit duhet te jete 25 mm/kV.

#### **3.3 SISTEMI I TOKEZIMIT**

TM 35, 20, 10 dhe sistemi 6 kV : Me neuter te izoluar.

Sistemi TU 0.4 kV : Neuter te tokezuar direct

#### **3.4 NIVELI I IZOLIMIT DHE LIDHJES SE SHKURTER**

##### **NIVELI I IZOLIMIT**

Paisjet duhet te plotesojne nivelin e izolimit permendur me poshte. Per percaktime dhe perfundime ne parametrat e nivelit te izolimit, do te perdoren shkurtimet e meposhtme.

- AC Tensioni qe duron ne frekuence industriale, 60 sekonda

- Li Tensioni impulsive qe duron, 1,2 / 50  $\mu$ sec

- SI Tensioni impulsive qe duron ne kycje, 250/3500  $\mu$ sec.

##### **NIVELI I IZOLIMIT RRJETI 35 KV**

1) Tensioni me i larte i sistemit 38.5 kV rms

2) AC 70 kV rms

3) Li 170 kVrms

4) Neutri i transformatorit AC Plotesisht e izoluar.

#### **NIVELI I IZOLIMIT RRJETI 20 KV**

- 1) Tensioni me i larte i sistemit 24 kV rms
- 2) AC 50 kV rms
- 3) Li 125 kVrms
- 4) Neutri i transformatorit AC Plotesisht e izoluar.

#### **NIVELI I IZOLIMIT RRJETI 10 KV**

- 1) Tensioni me i larte i sistemit 12 kV rms
- 2) AC 28 kV rms
- 3) Li 75 kVrms
- 4) Neutri i transformatorit AC Plotesisht e izoluar.

#### **NIVELI I IZOLIMIT RRJETI 6 KV**

- 1) Tensioni me i larte i sistemit 7.2 kV rms
- 2) AC 20 kV rms
- 3) Li 60 kVrms
- 4) Neutri i transformatorit AC Plotesisht e izoluar.

#### **3.5 NIVELI I IZOLIMIT DHE HAPESIRAT**

Paisja duhet te jete e pershtatshme per perdorim te vazhdueshem ne nje sistem tre faze 50 Hz. Hapesira(distance) e punes siguroar ne instalimet e jashtme midis paisjes se izoluar dhe pjese me te afert metalike nuk duhet te jete me pak se hapesira e sepecificuar dhe nese nuk eshte e specifikuar duhet te aplikohet standarti IEC per hapesirat. Distanca e shkarkimit ne izolatore dhe pjastra nuk duhet te jete me e vogel se 25 mm/kV ne sistemin me tension me te larte per paisjet e jashtme.

#### **3.6 NIVELI I LIDHJES SE SHKURTER**

Paisja duhet te kete nivel te lidhjes se shkurter si me poshte.

##### **Rrjeti 35 kV, niveli i lidhjes se shkurter**

- 25 kA rms, 3 sekonda
- 50 kA pik.

##### **Rrjeti 20 kV, niveli i lidhjes se shkurter**

- 25 kA rms, 3 sekonda
- 40 kA pik.

##### **Rrjeti 10 kV, niveli i lidhjes se shkurter**

- 25 kA rms, 1 sekonde
- 40 kA pik.

##### **Rrjeti 6 kV, niveli i lidhjes se shkurter**

- 25 kA rms, 1 sekonde
- 40 kA pik.

#### **4. PERSHKRIM, KERKESA DHE TE DHENA PER TRANSFORMATORET**

Transformatorët do të kete vlere nominale te tensionit prej -/0.4 kV.

Regullatori I tensionit I cili vendoset ne anen TM, do te jete plus-minus 5 % me 2.5 % ne cdo shkalle.

Grupi I lidhjes do të jetë sipas faktit ose kerkeses.

Daljet TM dhe TU te transformatorit do te jene per kablllo.

Temperatura maksimale e lejuar do te jete:

- Vaji 60o C (pjesa e sipërme)
- Peshjtjellat 65o C (shtresa më e nxehtë)

Transformatori i fuqisë do të jetë i ndërtuar në atë mënyrë që të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- Të ketë cilësinë për t'i rezistuar çdo tronditjeje gjatë transportit dhe instalimit
- Të sigurojë shpërndarje efikase të nxehtësisë
- Të jetë I papershkueshen nga uji dhe vaji i nxehtë
- Të kete zhurma dhe dridhje deri në një nivel te lejueshem.

### **Nukli I transformatorit**

Konstruksioni i qarkut magnetic duhet te jete i tille qe te shmange zhvillimin e shkarkimeve statike te lidhjes se shkurter ne konturin e brendshem ose ne strukturen fiksuese te tokezuar dhe prodhimin e komponentes se fluksit pingul me fleten e celikut te petezuar.

Çdo fletë e petëzuar do të izolohet me material te qëndrueshëm në kushtet e punës.

Qarku magnetic do te tokezohet nepermjet nje lidhje testuese te heqeshme me konstruksionin metalik, e cila vendoset ne nje pozicion te favorshem.

Nukli i transformatorit do të jete prej çeliku të cilësisë së lartë me kristale te orientuara. Nukli duhet te jete i perbere nga flete celiku te petezuara dhe çdo fletë e petëzuar do të jetë e izoluar me llak të përshtatshëm për të shmangur humbjet nga rrymat fuko

Nukli do te mbeshtetet ne bazament nepermjet fiksueseve te izoluara dhe do te tokezohet nepermjet nje lidhje te heqeshme.

Nukli (fletet e llamarines)do të jetë i mbrojtur ndaj gërryerjes duke u lyer me nje shtrese llaku me trashësi e pakta 1mm.

### **Peshjtjellat**

Transformtorët do të kene peshjtjella bakri elektrolit me përcjellshmëri të lartë ose peshjtjella alumini. Materiali i izolimit do të jetë e Klases A (IEC 76-2).

Izolimi i peshjtjellave dhe lidhjet do te jete I lire nga kompozimi I izolacionit per te zbutur tkurjen ose keputjen gjete shfrytezimit. Peshjtjellat do të jenë prej bakri elektrolitik ose alumini . Në mënyrë që të arrihet qëndrueshmeria ndaj lidhjeve te shkurtra nga ana e tensionit te ulet , peshjtjella e tensionit te ulet do te ndertohet me shirita bakri ose alumini ne vend te percjellesave. Transformatori do të ketë izolim të Klases A ose izolim më të mirë. Peshjtjellat mund të izolohen me letër izoluese ose llak në përputhje me standardet e Prodhuesit. Ndertimi I peshjtjellave do të jetë i tillë që të arrihet një shpërndarje e njetrajteshme e tensioneve impulsiv dhe tensioneve te shkarkimeve, duke shmangur pikat e dobëta në izolim.

### **Kazani**

Kazani i transformatorit do të prodhohet prej materiali me trashësi dhe fortesi të tillë që të rezistojë pa u dëmtuar apo pa u mbinxehur në kushtet e punës ose gjatë lidhjes se shkurtër. Transformatori do

të jetë pa zgjerues vaji .Për kazanin dhe pjese të tjera, preferohet të përdoren konstruksione të salduara. Sistemi ftohës i transformatorit do të jetë me fletë llamarine ne pjeset anesore te depozitës. Transformatori do të pajiset me rrota qe levizin ne të dyja drejtimet për instalimin në objekt.

### Rregullatori i tensionit

Rregullatori I tensionit do të sigurohet nëpërmjet një çelësi dhe do të vendoset në një vend të përshtatshëm (mbi kapak) për tu manovruar lehtësisht.

Rregullatori I tensionit do te pajiset me nje celes rregullues me doreze te jashtme rrotulluese qe siguron bllokimin e rregulluesit ne pozicionin e zgjedhur.

Mekanizmi duhet të jete nga jashtë transformatorit per manovrimin e tij. Pozicionet e rregullatorit te tensionit duhen shënuar qartë dhe të mos fshihen me kalimin e kohes. Pozicionet që korrespondojnë me vleren e rregullimit te rregullatorit do të stampohen ose do të gdhenden në një pllakë metali treguese, e fiksuar ne kapakun e transformatorit.

### Vaji izolues

Transformatori do të pajiset me sasinë e duhur të vajit izolues me përmbajtte minerali të cilësisë së lartë. Vaji do të jetë në përputhje me Standardin IEC 296 (Class 11).

## 5. TE DHENA TEKNIKE

Nr	Lloji I transformatorit	Trasformatore tre fazore te zhytur ne vaj, te mbyllur hermetikisht, per perdorim te brendshem ose te jashtem	
1	Standarti I aplikuar		
2	Fuqia nominale ( $S_n$ )	kVA	Sipas faktit
3	Tensioni nominal	kV	Sipas faktit
4	Numri I fazeve TM		3
5	Grupi I lidhjes		Sipas faktit
6	Tensioni ne qark te shkurter 75 °C	%	Sipas faktit
7	Frekuenca	Hz	50
8	Kufijte e rregullimit te tensionit në TM		$\pm 2 \times 2,5\%$ ;
9	Sistemi I tokezimit TM		I izoluar
10	Tensioni I ulet nominal	V	400/230
11	Numri I fazeve TU		3 faze/4 percjelles
12	Sistemi I tokezimit TU		Direkt me token
13	Tensioni qe duron ne frekuencen e fuqise per (1 min) TU	kV	3
14	Lloji I ftohjes		ONAN

## 6. HUMBJET

Transformatoret kerkohen qe te kene humbje minimale.

Ofertat me humbje te ulta ne transformator jame te preferueshme. Per kete arsye oferta me humbjet me te ulta ne transformator do te merret si reference dhe te gjithë humbjet e transformatoreve te tjere do te kapitalizohen me vlerat e vendosura me siper shtuar ne vleresimin e cmimit te ofertes per secilen oferte. (shiko 8.C)

## 7. TESTET

Transformatoret e shperndarjes duhet te testohen si me poshte:

## **Llojet e testeve**

- Matja e rezistences omike te peshtjellave ne temperaturen 20 °C
- Matja e rezistences se izolimit te peshtjellave ne temperaturen 20 °C
- Matja e koeficientit te trasformimit dhe grupit te lidhjes
- Provat e punimit pa ngarkese
- Provat e lidhjes se shkurter
- Provat me tesion te ritur
- Matja e rrymave te rrjedhjes
- Matja e tangent deltes

## **8. GARANCITE DHE PENALITETET**

### **A. GARANCIA E PERGJITHSHME**

Oferta duhet te garantoje qe:

- 1) Te gjitha punimet dhe materialet duhet te jene conform specifikimeve dhe standarteve.
- 2) Te gjitha punet dhe materialet duhet te jene ne perputhje me blerjen e materialeve , skemat, fabrikimin , praktiken e ndertimit dhe procedurat dhe duhet te jete konform te gjitha standarteve .
- 3) te gjitha materialet , pjeset dhe aksesoret duhet te jene te rinj. Prodhim i fundit , pa defekte, te cilesise me te mire, e pershtatshme per qeliminim qe te permbushe te gjitha aspektet dhe kerkesat per kushtet e punes se ketij specifikimi.

### **Vlerat e garantuara**

Ofertuesi duhet te listoje specifikisht cdo perjashtim nga keto specifikime ne nje paragraph te ndare te quajtur "Perjashtime ne Specifikimet e Bleresit". Pllakata e ofertuesit per vlerat nominale te transformatoreve dhe aksesoret duhet te ruhet gjate jetegjatesise se paisjes sipas specifikimeve per kushtet e mirembajtjes.

Vlerat per tu garantuar duhet te permenden dhe identifikohen si ne listen e te dhenave teknike.

Ofertuesi duhet te garantoje keto vlera, bleresi kufizon te drejten per te refuzuar ndonje paisje qe nuk eshte sipas vlerave te kerkuara.

### **B. GARANCITE E KERKUARA**

#### **Lidhja e shkurter**

Rezistenca e lidhjes se shkurter dhe zero impedance  $Z_0$  nuk duhet te ndryshoje me shume se 10 perqind e vleres se specifikuar.

#### **Humbjet**

Humbjet qe tejkalojne vlerat e garantuara, pas nje renie prej 2 perqind te tolerances, do te penalizohet si me poshte

- Humbjet pa ngarkese ALL 4'000.--/kW

- Humbjet me ngarkese ALL 1'500.--/kW

Transformoret do te refuzohen nese humbja totale tejkalon 10 % te vleres se garantuar ose nese humbjet pjesore tejkalojne 15 % te vleres se garantuar.

Nuk paguhet demshperblim nga bleresi per humbjet e garantuar me poshte.

#### **Rryma pa ngarkese**

Toleranca e rrymes ne punim pa ngarkese duhet te jete maksimumi plus 30 perqind e vleres se garantuar.

#### **Raporti tensionit**

Toleranca ne punim pa ngarkese, ne rregullatorin ne pozicionin kryesor per peshtjellen TM/TU duhet te jete  $\pm 0.5$  % e raportit nominal te tensionit dhe me pak se  $\pm 0.7$  % ne pozicionet e tjere.

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimi

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2022,2023, me nje vlere jo me te ulet se 40% e fondit limit te ketij prokurimi. **Kjo Kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kerkuara jane ne perputhje me percaketimin e nenin 43/2 te VKM nr. 285 dhe tregon kapacitetin financiar te operatoreve ekonomik ofertues, duke vertetuar qendrushmerine dhe ekspriencen e operatoreve.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43/1 të VKM 285, ku është lene mundesi entit prokrurues qe te kerkoj vertetim mbi xhiron deri ne tre vitet e fundit te operatoreve ekonomik.

**2.2.2.**Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancin vjetor, për vitin financiare 2022, 2023 shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe sherben per te njohur gjendjen financiare te operatoreve ekonomik ofertues



## 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1 Shërbime të mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 20% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vertetuar me dokumentacionin vertetues si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vertetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses.

---

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë,
- ISO 45001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë.
- ISO 14001 për menaxhim mjedisi.

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet. Certifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme vendosur bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Keto kritere janë gjykuar si të domosdoshme, pasi keto certifikata ka të bëjnë me tre elemente shumë të

rendesishem, siç janë: Cilesia e kryrjes së shërbimit; siguria e jetës dhe e shëndetit të punonjësve gjatë kryrjes së proceseve të punës; ruajtja e mjedisit gjatë procesit të shërbimeve. Operatorët ekonomik ofertues të cilët posedojnë këto certifikime janë garanci për autoritetin kontraktor që të respektojnë standartet e mesiperme..

**2.3.2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vertetim, për punësim mesatar jo më pak se 5 (pese) punonjësish, ku përfshihet edhe minimalisht një inxhinier elektrik i pajisur me Diplome.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- kartelat perkatese të sigurimit teknik
- Listepagesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për periudhën **Qershor 2024** të konfirmuara nga administrata tatimore
- Për inxhinierin pjesë e stafit i cili duhet detyrimisht të jetë i pasqyruar në listepagesat e shoqërisë për periudhën e mesiperme, duhet të paraqitet kontratë noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të shërbimeve për këtë objekt si edhe diplomë + CV

***Për të përmbushur këtë kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.***

### **Argumentimi**

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Në rastin konkret është e domosdoshme stafi i specializuar pasi kemi të bëjmë me një proces pune që kerkohen njohuri specifike për të gjithë procesin.

Gjithashtu, bazuar në ligjin nr. Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se pagesat e kontributeve bëhen: “*Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. , kemi përcaktuar listepagesat e mujit Maj 2024.*

**2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:**

- Bango per montimin e nukleve te transformatoreve ( kryen assemblimin e fleteve te nuklit me saktesi)
- Bobinatrice per avolzhimin transformatoresh me flete alumini dhe bakri ( kryen pergatitjet e peshtjellave sekondare dhe primare te transformatoreve)
- Bobinatrice per avolzhim transformatoresh me tel bakri dhe alumini ( kryen pergatitjet e peshtjellave sekondare dhe primare te transformatoreve)
- Filter prese per pastrimin e vajit te trasformatoreve; (kryen filtrimin mekanik te vajit)
- Filter vakum per pastrimin kimik te vajit te trasformatoreve me kapacitet deri ne 6000 lit /ore; ( kryen filtrimin kimik dhe heqjen e lageshtires se vajit)
- Furre elektrike e montuar ne fabrike; (ben tharjen e bobinave sekondareve , primare , nukleve, dhe aksesoreve te transformatoreve)
  
- Mjet ngrites (pirun) deri 5 ton. (sherben per levizjen e e peshave te renda brenda dhe jashte repartit)
- Pajisje saldimit per hekur, baker dhe alumini; (kryen sherbimin e saldimit te zbarave te aluminit dhe bakerrit me TIG)
- Vinc elektrik minimumi 2.5 ton i montuar ne repartin e riparimit te transformatoreve (ne oficine), qe sherben per hapjen dhe mbylljen e transformatoreve gjate riparimit.
- Makineri per perpunim teli gjate procesit te avolzhimit .( sherben per procesin e thurjes se bobinave te bakrit dhe aluminit)
- Pajisje per matjen e humbjeve te transformatoreve pa ngarkese dhe lidhjes se shkurter.
- Pajisje per testimin e transformatoreve me tension te aplikuar deri ne 100 kV
- Pajisje per testimin e transformatoreve me tension te induktuar dyfish (2Un) dhe frekuence dyfishe (100 Hz).
- Pajisje per matjen e tensionit te çpimit te vajit te transformatoreve deri ne 80 kV.

Operatori ekonomik duhet te vertetoje pronesine e makinerive / pajisjeve te mesiperme nepermjet faturave tatimore te blerjes, kontrate blerje, kontrate dhurimi apo cdo forme tjeter e fitimit te pronesise sipas kodit civil, ose nepermjet deklarates noteriale te shoqeruar me fotografite e makinerive / pajisjeve, ose nepermjet kontrates se qirase per makinerite / pajisjet e marra me qira, e cila duhet te shoqerohet me aktin e pronesise mbi makinerite / pajisjet qe merren me qira.

Në konsideratë të përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të

dorëzuara në rrugë elektronike, duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

***Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.***

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme vendosur bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 41, PIKA 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Mjetet dhe pajisjet teknike janë të domosdoshme për të kryer shërbimet e parashikuara sipas sasive dhe specifikimeve teknike. Procesi i avolzhimit nuk mund të kryhet pa këto pajisje me anë të se cilave garantohen rezultatet e kërkuara në fund të procesit.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi (provuar kjo me dokumentacion pronësie, me një format të pronësisë të parashikuar në Kodin Civil) ose me qira (provuar me kontratë qiraje para noterit) një ambient, për ofrimin e shërbimit të riparimit të transformatoreve dhe pompave.

***Për të përmbushur këtë kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e hapësirave në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.***

Në konsideratë të përcaktimit të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme vendosur bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 41, PIKA 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ambjenti ku do të kryhet procesi i avolzhimeve është i domosdoshëm, duke pasqyruar një ser procesesh që duhet të kryhen.

Njesia e Prokurimit

